




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË**



Nr. 428..Prot

Tiranë, më 30./07./2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit Nr.4, datë 18.08.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 759, datë 30.09.2024" Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Udhëzimit Nr. 1109, datë 16.12. 2024 PËR PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË VALIDIMIT TË TË NXËNIT TË MËPARSHËM JOFORMAL DHE INFORMAL

Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1.(një) Këshillues për validimin të të nxënimit të mëparshëm joformal dhe informal (Kohë e plotë)

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme për vend të si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2. Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme si vijon:

Kritere të posaçme për Këshillues për validimin e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal:

- a) njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në praktikat e këshillimit dhe orientimit, mundësisht për të rritur.
- b) njohuri për politikat publike dhe orientimet kryesore strategjike në fushën e arsimit dhe formimit për të rriturit/të nxënit gjatë gjithë jetës;
- c) nivel të kënaqshëm njohurish për kuadrin ligjor të njohjes, si dhe për të drejtat dhe detyrat e kandidatëve, plus trajnimin fillestar;
- ç) diplomë “Bachelor” – niveli 6 i KSHK-së në shkencat shoqërore, ose në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore ose fusha të ngjashme

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës ...10.08.2026

4. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar pëcakrimeve të Udhezimit Nr 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, perberjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar

